



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "International Security Association" për aktivitetin: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

V E N D I M

REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "International Security Association" e datës 17.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 13.05.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 13.05.2020 ;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "International Security Association" me datë 17.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 18.05.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsye të vijim:

-Autoriteti Kontraktues në vazhdimësi ka repektuar të gjitha kërkesat nga FDT-ja dhe rekomandimet e Vendimeve të OSHP-se, pasi që në asnjë rast çmimi i dhënë nga ju nuk ka mbuluar kërkesat ligjore për lartësi të kërkuar të pages;

-Në asnjë rast as Autoriteti Kontraktues e as OSHP-ja nuk e kanë trajtuar tenderuesin : "Rojet e Nderit" si të pa përgjegjshëm, por vetëm është konstatuar se çmimi i tij është mbi vlerën e parashikuar;

-Ne dy Vendimet e fundit te OSHP-se eshte rekomanduar qe çmimet te analizohen ne harmoni me interpretimet e ATK-se per pagat dhe bazuar ne te njejtat dhe ne te gjitha kriteret e matshme ne nje vleresim paraprak eshte propozuar per dhenje te kontrates tenderuesi "Commando",por me Vendimin e fundit eshte konsideruar i pa pergjegjshem nga OSHP-ja dhe i vetmi tenderues qe ploteson keto kerkesa ka mbetur tenderuesi "Rojet e Nderit".Per kete edhe eshte rekomanduar i njehti per dhenje te kontrates.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit